



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës
Ministarstvo za Kosovske Bezbednosne Snage / Ministry for the Kosova Security Force

Në mbështetje të nenit 145, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjin Nr.03/L-045 për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Ligjin Nr. 03/L-46 për Forcën e Sigurisë së Kosovës, neni 9, pika 9.1, nenin 13, dhe Rregulloren Nr. 02/2013 për Rekrutimin në FSK, neni 12, si dhe duke pasur për bazë ofertën e Departamentit të Mbrojtjes së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës shpall:

K O N K U R S
Për rekrutimin kadetëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës

Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK) ushtron mbikëqyrje civile dhe kontroll demokratik mbi FSK-në dhe udhëhiqet nga Ministri i FSK-së, i cili i përgjigjet Kuvendit të Kosovës. Ministria është përgjegjëse për zbatimin e politikave qeveritare për sa iu përket çështjeve që ndërlidhen me FSK-në dhe po ashtu do të veprojë edhe si shtabi i nivelit më të lartë të FSK-së.

Forca e Sigurisë së Kosovës është forcë krejtësisht vullnetare e ndërtuar nga të gjitha shtresat e shoqërisë. Misioni i Forcës së Sigurisë së Kosovës, si instrument i sigurisë është që ta mbështesë Qeverinë e Republikës së Kosovës. Detyrat fillestare të Forcës së Sigurisë janë; Të marrë pjesë në operacionet për reagim ndaj krizave, përfshirë operacionet në mbështetje të paqes. Kjo do të përfshijë operacionet jasht territorit të Republikës së Kosovës, ku do të ftohet për këtë qëllim; të ndihmojë autoritetet civile në përgjigje ndaj fatkeqësive natyrore, fatkeqësive dhe emergjencave tjera, madje edhe si pjesë e një përpjekjeje reaguese regjionale apo ndërkombëtare; të kryejë shkatërrimin e mjeteve shpërthyes; të ndihmojë autoritetet civile përmes operacioneve të mbrojtjes civile. Forca e Sigurisë së Kosovës fillimisht do të përbëhet nga Komanda e Forcave Tokësore, Brigada e Reagimit të Shpejtë, Brigada e Mbështetjes së Operacioneve dhe Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes.

Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) bën pranimin e kadetëve të cilët do të studiojnë në Akademinë Ushtarake-WEST POINT të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

A. Kandidati që aplikon për kadet duhet;

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës,
- Të ketë kryer shkollën e mesme duke përfshirë edhe testin kombëtar të maturës deri më 15.07.2015,
- Të mos jetë i/dënuar apo i/e ndjekur penalisht nga organet e drejtësisë,
- Moshë minimale-të jetë i moshës 18 vjeç,
- Moshë maksimale-të mos jetë 23 vjeç para datës 1 korrik 2016,
- Kandidatët nuk duhet të jenë të martuar, ose të kenë ndonjë detyrim tjetër ligjor për të mbajtur një apo më shumë fëmijë, si dhe femrat të mos jenë në periudhën e shtatëzënisë,

- Kandidatët duhet të kenë njohuri të mira me rrjedhshmëri të mjaftueshme të gjuhës angleze në të folur, shkruar dhe në të kuptuar,
- Të kenë njohuri të mira matematikore, zotësi të mira të fitnestit fizik, si dhe të jenë plotësisht të përshtatshëm për shërbim në aspektin mjekësor.

B. Procedurat e testimit;

I) Faza para-kualifikuese

- Ese në gjuhën angleze,
- Testi i Gjuhës Angleze (ELC),
- Testi i Aftësive,
- Testi fizik (faza e parë),
- Testit TOEFL-provues,
- Testi SAT-provues,
- Kontrollimi Mjekësor.

II) Përgatitja për procesin e testeve në fazën kualifikuese

III) Faza kualifikuese,

- Testi TOEFL,
- Test SAT,
- Intervista,
- Testi fizik (faza e dytë),
- Aplikimi.

C. Dokumente për aplikim;

- Diploma origjinale e shkollës së mesme (përveç origjinalit duhet të ofrohet edhe versioni zyrtar i diplomës së shkollës së mesme i përkthyer në gjuhën angleze),
- Tri vlerësime shkollore zyrtare (letra rekomandimi),
- Dëshmitë zyrtare të përfundimit të Testit TOEFL dhe Testit SAT (**janë të dëshirueshme**),
- Dëshmi, certifikata, mirënjohje (nëse posedon),
- Ekstrakti i lindjes,
- Vërtetimin nga gjykata që nuk është nën hetime apo i ndjekur penalisht,
- Kopje të letërnjoftimit apo pasaportës,
- Dy fotografi të formatit (5 cm x 5 cm).

D. Shënim;

- *Kandidatët që ofrojnë dëshmitë zyrtare të përfundimit të Testit TOEFL dhe Testit SAT nuk obligohen të testohen vetëm në TOEFL provues dhe SAT provues.*
- Pas përfundimit të procedurës së testimit, kandidatët do të nominohen nga Ministria e FSK-së si kandidatë konkurrent për studim në Akademinë Ushtarake WEST POINT të SHBA-së. Në rast të përzgjedhjes për shkollim, kandidatët të cilët përfundojnë suksesshëm shkollimin do të emërohen në Forcën e Sigurisë së Kosovës me kohëzgjatje minimale prej gjashtë viteve gjatë secilës kohë ky shërbim do të jetë i detyrueshëm për kandidatin,
- Procesi i përzgjedhjes së kandidatëve do të përfundoj deri më 28.02.2016,
- Konfirmimi i përzgjedhjes për shkollim në WEST POINT- Maj 2016,
- **Fillimi i shkollimit-Korrik 2016.**

F. Si të aplikoni;

Formularët për aplikim janë në dispozicion në Komandën e Forcave Tokësore, apo në ueb faqen e MFSK-së, www.mksf-rks.org, apo www.rks-gov.net/mfsk ku gjendet

shpallja e konkursit. Formularët duhet të dorëzohen personalisht, në këtë adresë: **Komanda e Forcave Tokësore, Kazerma „ Adem Jashari”, porta nr. 1, Prishtinë**, në çdo ditë pune nga ora 09:00-15:00 deri në afatin e fundit për konkurrim. **Kandidatët duhet t’ia bashkëngjisin aplikacionit kopjet e dokumenteve që dëshmojnë përmbushjen e kushteve të nevojshme.** Për informata plotësuese, mund të kontaktoni në nr. tel. 038- 603-355/199. Konkursi është i hapur prej datës **02.03.2015** dhe data e fundit e aplikimit është **27.03.2015**.

Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës iu shërben të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe mirëpret aplikacione të femrave dhe meshkujve për kadetë të FSK-së, pa dallim nga përkatësia e tyre etnike.